




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSh. nr.32/2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, dhe nenin 17 paragrafi 3 sipas procesverbalit të bordit të OSHP-së, të datës 30.09.2022, për Amandamentim të Rregullores nr.01/2020, me numër të protokollit 83/2022, pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik (OE) "HORN &Co. Kosova SHPK dhe Infra Plus" SHPK" Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Rrënimi – Ekzekutimi i Objekteve të ngritura pa leje ndërtimi –Ilegale dhe Shërbime tjera" me numër të prokurimit: 632-22-11389-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Gjakovë, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj - Mexhuani me datën: 20 janar 2023 mori këtë:

VENDIM

- 1. Hedhet si e pa lejuar** ankesa e datës 11.01.2023 (protokoll 32/2023) e OE "HORN &Co. Kosova SHPK dhe Infra Plus" SHPK" Prishtinë, e ushtruar për aktivitetin e prokurimit me titull: "Rrënimi – Ekzekutimi i Objekteve të ngritura pa leje ndërtimi –Ilegale dhe Shërbime tjera" me numër të prokurimit: 632-22-11389-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Gjakovë.
- 2. I lejohet** autoritetit kontraktues – Kuvendi Komunal Gjakovë, që të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rrënimi – Ekzekutimi i Objekteve të ngritura pa leje ndërtimi –Ilegale dhe Shërbime tjera" me numër të prokurimit: 632-22-11389-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Gjakovë, përkitazi me këtë ankesë nëse nuk ka ankesë tjetër .
- 3. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së operatorit**

ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 11.01.2023, ka pranuar ankesë nga OE "HORN & Co. Kosova SHPK dhe Infra Plus" SHPK" Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Rrënimi – Ekzekutimi i Objekteve të ngritura pa leje ndërtimi –Ilegale dhe Shërbime tjera" me numër të prokurimit: 632-22-11389-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Gjakovë, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 32/2023

Për aktivitetin prokurimit të cekur si më lart autoriteti kontraktues me datën 06.12.2022, ka publikuar B58 Njoftimi për dhënie të kontratës.

Me datën 09.12.2022, OE parashtroi kërkesë për rishqyrtim në AK.

Me datën 16.12.2022, AK merr vendim me të cilin e aprovon kërkesën për rishqyrtim dhe aktivitetin e prokurimit në fjalë e kthen në Rivlerësim, pas rivlerësimit AK me datën 30.12.2022, publikon vendimin e ri B58 Njoftim për dhënie të kontratës ku OE "HORN & Co. Kosova SHPK dhe Infra Plus" SHPK" Prishtinë, tani më nuk parashtroi fare kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të datës 30.12.2022, por me datën 11.01.2023, parashtroi ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Organin Shqyrtues i Prokurimit me datën 11.01.2023, i drejtohet me shkresë zyrtare email OE ankues duke i kërkuar sqarime, se a kanë dorëzuar kërkesë për rishqyrtim në AK kundër vendimit të datës 30.12.2022, OE kthen përgjigje në të cilën ndër tjera thotë se është pse kërkesa e tyre e pare është aprovuar AK prapë ka vazhduar me dhënien e kontratës OE të njëjtë andaj edhe ne ju kemi drejtuar OSHP-së me ankesë.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Organin Shqyrtues i Prokurimit konsideron se duke marr parasysh faktin, se AK ka publikuar një vendim të ri B58 Njoftim për dhënie të kontratës me datën 30.12.2022, pas aprovimit të kërkesës për rishqyrtim të OE ankues të datës 09.12.2022, OE ankues ka qen i obliguar që në pajtim me nenin 108/A të LPP-së, të parashtroj kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, OE në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të duhej të drejtohet me ankesë OSHP-së.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se OE ankues nuk ka ushtruar fare kërkesë për rishqyrtim pas vendimit të AK-së B58 Njoftimi për dhënie të kontratës të datës 30.12.2022.

OSHP konstaton se është e pa kontestueshme se OE ka parashtuar kërkesë për rishqyrtim në

AK, por këtë kërkesë ankuesi e ka parashtruar kundër vendimit të AK B58 Njoftimi për dhënie të kontratës, të datës 05.12.2022 dhe për këtë kërkesë OE ankues ka marrë një vendim nga AK ku kërkesa e tij ishte aprovuar si e bazuar dhe aktiviteti i prokurimit në fjalë është kthyer në Rivlerësim. Dhe vetëm pas Rivlerësimit AK kishte publikuar vendimin e ri B58 Njoftim për dhënie të kontratës me datën 30.12.2022.

Duke pas parasysh faktin se OE ankues nuk është pajtuar edhe me vendimin e fundit të AK-së B58 Njoftim për dhënie të kontratës të datës 30.12.2022, ankuesi është dashtë që kundër këtij vendimi fillimisht të ushtroj kërkesë në autoritet kontraktues nga se nenin 109 i LPP -së specifikon: Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 11.01.2023 (protokoll 32/2023) nga OE "HORN & Co. Kosova SHPK dhe Infra Plus" SHPK" Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Rrënimi – Ekzekutimi i Objekteve të ngritura pa leje ndërtimi – Ilegale dhe Shërbime tjera" me numër të prokurimit: 632-22-11389-5-2-1, iniciuar nga AK Kuvendi Komunal Gjakovë, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar fare kërkesën për rishqyrtim kundër vendimit të AK-58 Njoftimi për dhënie të kontratës të datës 30.12.2022. Përfundimisht ankesa e lartcekur është ushtruar në OSHP në kundërshtim me nenin 108/A dhe nenin 109 të Ligjit për Prokurim Publik si dhe nenit 4 "e Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta ankesë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Vendimi sikurse në dispozitivin tek pika 3 e këtij vendimi u dha në kuptim të paragrafit 4 të nenit 31 si dhe paragrafi 6 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Kuvendi Komunal Gjilan

1x1 OE "HORN & Co. Kosova SHPK dhe Infra Plus" SHPK" Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së

Kryetarja e OSHP-së

Vjosa Gradinaj Mexhuani